

AVOKAT -LAWYER  
**TOMË (VIKTOR) GASHI**

Oda e Avokatëve të Kosovës / Kosova Chamber of Advocates  
Sheshi "Nënë Tereza" Rr./str. Rexhep Luci Nr. 1 Kati- I – mbi Kino ABC -PRISHTINË  
Tel & Fax : + 383 38 227 227 Mob:+383 44 11 82 92  
E-mail:tgashi@gmail.com

**PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË**

PËR: Kryeprokurorin Z. Kujtim Munishi

TË NJOFTOHE: Prokurori i Shtetit z.Aleksandër Lumezi

NGA: Tomë GASHI, avokat

Në bazë të nenit 79 al 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës Paraqes këtë :

**KALLËZIM PENAL**

**Kundër:**

**Z. Sylë Hoxha** –ish Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ish Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, me vendbanim në Prizren, rruga Caralevës me nr. 25.

Shënime tjera të sigurohen zyrtarisht.

**Sepse:**

Ekziston dyshimi i bazuar se më 05.11.2016 në ditën e vrasjes së aktivistit të Lëvizjes VETËVENDOSJE Astrit DEHARI në qendrën e paraburgimit në Prizren, në cilësinë e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, duke keqpërdorur pozitën e tij zyrtare, dhe duke mos ndërmarrë veprime të domosdoshme e në kuadër të detyrës dhe autorizimeve të tij zyrtare, për të siguruar prova që do të identifikonin vrasësit e Astrit Deharit, më pastaj për të identifikuar urdhërdhënësit për vrasje, dhe ata që e fshehën vrasjen e Astrit Deharit.

Më datë 18.11.2016 qëllimisht duke e keqintepretuar ekspertizën e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, dhe duke tentuar që vrasjen e Astrit Deharit ta paraqes si vetëvrasje, deklaroi se "të gjitha provat dhe ekzaminimet të kryera gjatë proesit hetimor demonstrojnë se ky rast ishte vetëvrasje".

Në të njëjtën konferencë për shtyp në zyrën e Prokurorit të shtetit **z.Sylë Hoxha** rrejshëm deklaroi se kinse në qendrën e paraburgimit në Prizren "nga ora 14:00 gjer në orën 15:00 nuk është vërtetuar ndërhyrje-lëvizje nga faktori i jashtëm në dhomën A3 ku është gjetur tani i ndjeri Astrit Dehari". Ndërsa në televizionin KTV në emisionin Rubikon me datë 09.11.2016 i pyetur se kur u njoftuar dhe nga kush (për rastin) z.Hoxha ka deklaruar se:

"Nga drejtori i qendrës së paraburgimit në Prizren dhe jam njoftuar dikun rreth orës 14:00 mos gabofsha, por të jam i sigurtë unë nuk kam qenë në Prizren atë ditë, kam qenë jashtë qytetit, mund të ketë thirrur më herët ndoshta se kam qenë në Prevallë duke u kthyer, ka qenë ditë vikendi e kështu me radhë..."

Pra, **z. Sylë Hoxha** në cilësinë e Kryeprokurorit sipas tij paska qenë i njoftuar për vdekjen e Astrit Deharit para se ajo të ndodhë!

Pretendimet e Kryeprokurorit **Sylë Hoxha** se Astrit Dehari kishte kryer vetëvrasje janë demantuar me ekspertizën e ekspertëve të pavarur Dr. Besim Ymaj dhe Dr. Besim Latifaj të cilët ndër të tjera kanë konstatuar se lëndimet në kokë dhe në pjesë të tjera të trupit të Astrit Deharit janë lëndime trupore me natyrë më shumë si shenja të vetëmbrojtjes.

Konstatimi i shenjave vetëmbrojtëse janë konstatime mjeko-ligjore ndërsa perfudimi juridik është se kemi të bëjmë me vrasje.

Poashtu me ekspertizën e Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, datë 09 shtator 2019 me të cilën në konkluzionet e tyre nën pikën një (1) është konstatuar se hipoteza e vetëvrasjes së Astrit Deharit përmes mjeteve të caktuara nga mjekët ligjor (nga Instituti i Mjekësisë ligjore në Prishtinë) duket pak e vërtetë dhe intervernimi i një personi të tretë në procesin fatal duhet të kihet parasysh. Ndërsa në pikën 3 të këtij konkluzioni thuhet se "një hetim i ri është i nevojshëm për të qartësuar rrethanat e vdekjes së Astrit Deharit".

Ndërsa hetimet për rastin e vrasjes së Astrit Deharit ede nuk janë mbyllur as pas 4 viteve dhe rasti është duke u hetuar ne prokurorinë speciale të Republikës së Kosovës i regjistruar në numrin: PP nr. 384/19. **Z.Sylë Hoxha** në cilësinë e Kryeprokurorit nuk i ka përmbushur detyrat e tij dhe duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tij zyrtar të gjitha veprimet dhe mos përmbushjen e detyrave të tij i ka bere me qellim që të shkilen të drejtat e familjës së Astrit Deharit për një hetim të pavarur dhe të bazuar në ligj për të identifikuar vrasësit, shtytësit në vrasje dhe ata që e fshehën vrasjen e Astrit Deharit për më tepër se 4 vite.

**Me këtë i paraqituri Sylë Hoxha ka kryer veprën penale: Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit zyrtar nga neni 414 al. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

## A R S Y E T I M

Astrit Dehari ka qenë aktivist i Lëvizjes VETEVENDOSJE!, i njejt i së ëbashku me pesë aktivistë të tjerë të Lëvizjes Vetëvendosje është arrestuar në gusht të vitit 2016 si njëri prej të dyshuarve kinse për gjuajtjen e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës me granata hedhës.

Astrit Deharit i është caktuar masa e paraburgimit nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe i njejt i është dërguar në qendrën e paraburgimit në Prizren.

Astrit Dehari për 78 ditë sa është mbajtur në qendrën e paraburgimit në Prizren, asnjëherë nuk është intervistuar zyrtarisht dhe nuk është marrë në pyetje zyrtarisht as nga policia dhe as nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e cila zhvillonte hetime për këtë rast.

Astrit Dehari është vrarë në qendrën e paraburgimit në Prizren me 05.11.2016, i njejt i është dërguar pa shenja jete ne qendren spitalore në Prizren në ora 15:20 që vërtetohet edhe nga raporti specialistik nr. 10169 dt. 05.11.2016.

Obduksioni është kryer në institutin e mjekësisë ligjore në Prishtinë me 07.11.2016 ku ndër të tjera ka marrë pjesë edhe i paraqituri **Sylë Hoxha** në cilësinë e kryeprokurorit të Prokurorisë themelore në Prizren si dhe ekspert të pavarur mjeko-ligjor Dr. Besim Ymaj dhe Dr. Besim Latifaj.

**Z Sylë Hoxha** në cilësinë e Kryeprokurorit më 09.11.2016 në KTV në emisionin Rubikon në pyetjet e moderatorit Adriatik Kelmendi se kur u njoftuat dhe nga kush (për rastin)- z.Hoxha ka deklaruar diçka tepër shokuese se:

*"Nga drejtori i qendrës së paraburgimit në Prizren dhe jam njoftuar dikun rreth orës 14:00 mos gabofsha, por të jam i singertë unë nuk kam qenë në Prizren atë ditë kam qenë jashtë qytetit, mund të ketë thirrurr më herët ndoshta se kam qenë në Prevallë duke u kthi, ka qenë ditë vikendi e kështu me radhë..."*

Si është e mundshme që **Z. Sylë Hoxha** në cilësinë e Kryeprokurorit të ketë ditur për vdekjen e Astrit Deharit që sipas tij ka ndodhur para orës 14:00 dhe ai është njoftuar për këtë nga drejtori i qendrës së paraburgimit në Prizren diku rreth ores 14:00 apo më herët dhe ai nuk i ka dhënë hetuesisë në dispozicion tabulatet e thirrjes telefonike në mes tij dhe drejtorit te burgut e poashtu nuk i ka dhënë hetuesisë tabulatet e thirrjes telefonike në mes të drejtorit të burgut dhe drejtorit të policisë regjionale të Prizrenit **Z. Nexhmedin Krasniqi** i cili po ashtu kishte deklaruar në media se kinse Astrit Dehari ka vdekur nga përdorimi i tepruar i medikamenteve gjë që është demantuar krejtësisht.

Poashtu në po këtë emision z. **Sylë Hoxha** deklaroi se:

*“Me korrektesinë më të madhe prej momentit e kemi marrë me seriozitet këtë çështje, nuk po du mi përsërit, nuk dyshoj në atë se ne kemi qu deri në fund hetimet me profesionalizëm, nëse dikush pas epilogut të rezultateve të hetimeve dyshon ajo është diçka tjetër, mirëpo deri në këtë moment ju them se me një përgjegjësi shumë të madhe dhe profesionale janë duke u kryer hetimet. Jeni të bindur, se s’po du, s’jom ardhë me la veten, për korrektësi edhe të opinionit, besoni se shumë landë tjera, shumë hetime tjera, i kemi ndalu dhe i kemi dhënë prioritet këtij rasti, edhe unë si kryeprokuror edhe prokurori i rastit...”*

**Z.Sylë Hoxha** ka tentuar që rastin e vrasjes së Astrit Deharit ta paraqesë si vetëvrasje dhe vrasjen ne burg të aktivistit të Lëvizjes VETËVENDOSJE ka tentuar që ta mbyllë si vetëvrasje 13 ditë pas vrasjës së Astrit Deharit dhe vetëm 11 ditë pas kryerjes së obduksionit. **Z.Sylë Hoxha** në karrieren e tij shumë vjeçare si prokuror por edhe asnjë prokuror tjetër i Republikës së Kosovës nuk ka tentuar asnjëherë që raste kaq të rënda t’i mbyllë në afat kaq të shkurtër kohor.

Për këto dhe për arsye të tjera që Prokuria Themelore në Prishtinë do ti gjejë në shkresat e lëndës të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të cilat janë të regjistruara në nr. PP.nr 384/19, i propozoj Prokurorisë Themelore në Prishtinë që të nxjerrë aktvendim për zhvillimin e hetimeve kundër të dyshuarit **Sylë Hoxha** në drejtim të veprës penale për të cilën është paraqitur ky kallëzim penal apo në drejtim të çfarëdo vepre penale që prokuroria e konsideron se në veprimet e të paraqiturit janë përmbushur elementet e ndonjë vepre tjetër penale të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

I propozojmë Prokurisë Themelore në Prishtinë që pas zhvillimit të hetimeve të ngrisë aktakuzë kundër të paraqiturit z. **Sylë Hoxha** në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe të kërkojë dënimin e tij sipas ligjit.

Shtesë:

*-Autorizimi i datës 11.02.2021.*

*-CD me inqizime me pjesë të deklaratave të z. **Sylë Hoxha** në emisionin Rubikon me datë 09.11.2016 dhe në konferencën për shtyp të zyrës së prokurorit me datë 18.11.2016.*

Me respekt,  
Tomë Gashi  
Prishtinë, 11.02.2021

